



Memorandum Mirëkuptimi

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Republika e Kosovës

dhe

Akademia e Drejtësisë (AD), Republika e Kosovës

Palët kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1

Qëllimi

- (1) Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Akademisë së Drejtësisë (AD) është vendosja e bashkëpunimit për të realizuar mandatin ligjor në mbështetje të të dy institucioneve në çështjet e fushëveprimit të përbashkët.
- (2) Bashkëpunimi reciprok i të dy palëve nënshkruese bëhet me qëllim të mbështetjes së procesit të avancimit profesional të sistemit prokurorial si dhe lehtësimit të zhvillimeve të programeve të trajnimit.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky bashkëpunim do të fokusohet në shkëmbimin e informatave dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnime, përcaktimin e politikave trajnuese, zbatimin e programit të trajnimeve, pjesëmarrjen në trajnime, shkëmbimin e të dhënave për trajnimet e realizuara dhe pjesëmarrësit, si dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve.

Neni 3

Këshilli Prokurorial i Kosovës

- (1) Këshilli Prokurorial i Kosovës do të angazhohet që:
 - (a) Të luaj rol proaktiv në vlerësimin e nevojave për trajnim të prokurorëve dhe stafit administrativ dhe të njoftoj AD-së me rezultatet e këtij procesi.

- (b) Të propozoj tema dhe programe trajnimi për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ.
- (c) Të hartoj politikat e trajnimeve për të përcaktuar parimet bazë për organizimin e trajnimeve dhe do të njoftoj AD-në.
- (d) Të mbështesë AD-në me hartimin e listave të pjesëmarrësve në trajnime specifike.
- (e) Të jap udhëzime për organizimin e trajnimeve specifike.
- (f) Në procesin e vlerësimit të ndikimit të trajnimeve.

Neni 4 **Akademia e Drejtësisë**

(1) Akademia e Drejtësisë do angazhohet që:

- (a) Të përfshihet KPK dhe Prokurori i Shtetit në procesin e hartimit të programit të trajnimeve.
- (b) Të përfshijë në programin e trajnimeve propozimet e KPK dhe Prokurorit të Shtetit.
- (c) Të përfshijë prokurorët dhe stafin e kualifikuar – trajnues - të sistemit prokurorial në zbatimin e trajnimeve për anëtarët e sistemit prokurorial.
- (d) Të jap informata KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit sipas kërkesave, për organizimin e trajnimeve dhe pjesëmarrjen në trajnime.
- (e) Të njoftoj KPK-në për të gjitha programet jashtë vendit të organizuara nga AD dhe të marrë rekomandimet e KPK-së për prokurorët që duhet të marrin pjesë në këto trajnime, në përputhje me programin dhe kompetencat e prokurorëve apo stafit.

Neni 5 **Shkëmbimi i të dhënave përmes bazave elektronike të të dhënave**

- (1) KPK dhe AD pajtohen që të bëhet integrimi i bazave elektronike të të dhënave respektive, për shkëmbimin e të dhënave bazike të prokurorëve dhe stafit administrativ, si dhe të dhënave për pjesëmarrjen në trajnime dhe programe tjera të Akademisë.
- (2) Gjatë këtij procesi duhet të mbrohen të dhënat personale dhe konfidenciale sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6 **Ndryshimi i këtij Memorandumi**

Çfarëdo ndryshimi i këtij memorandumi do të bëhet me pëlqimin e të dy palëve dhe në formë të shkruar.

Neni 7 **Kohëzgjatja**

Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga dy palët dhe do të zgjasë deri në ndërprerjen e tij nga palët.

Neni 8 **Ndërprerja**

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të ndërprehet me paralajmërimin e cilës do palë duke ofruar njoftim me shkrim një muaj më parë tek pala tjetër:

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Në pajtim të plotë, palët e nënshkruajnë këtë Memorandum të Mirëkuptimit me datë 20.03.2019

Për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Bahri Hyseni, Kryesues




Për Akademinë e Drejtësisë

Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv




Prishtinë, datë 20.03.2019